

V E N D I M
Nr.228, datë 19.5.1993

PËR MËNYRËN E SHPËRBLIMIT TË PUNËS SË TË DËNUARVE ME HEQJE TË LIRISË

Me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të dënuarit me heqje të lirisë punojnë në ato qendra pune që u ofron administrata e vendit të vuajtjes së dënimit, kur ajo mund të jetë vetë punëdhënëse ose i siguron në marrëdhënie me punëdhënësit e tjerë, persona fizikë e juridikë, shtetërorë e privatë vendas e të huaj.

2. Regjimi i punës i të dënuarve është i njëjtë me atë të punonjësve të lirë, me përjashtim të kufizimeve që rrjedhin nga specifika e vendit të vuajtjes së dënimit. Atyre u sigurohen kushtet e punës, të mbrojtjes individuale e kolektive sipas dispozitave në fuqi.

3. Për punën që kryejnë të dënuarit, shpërblehen sipas dispozitave në fuqi ose sipas përcaktimit që është bërë në kontratën e lëshuar ndërmjet administratës së vendit të vuajtjes së dënimit dhe personit juridik e fizik.

Të dënuarve u jepen të gjitha të ardhurat që burojnë nga puna e tyre, si për punonjës të lirë.

4. Të dënuarve, kur u sigurohet puna sipas profesionit ose e përshtatshme me mundësitë e tyre, janë të detyruar të përballojnë të gjitha shpenzimet vetjake që bëhen për ta në vendin e vuajtjes së dënimit me të ardhurat e tyre.

5. Kur administrata e vendit të vuajtjes së dënimit nuk siguron dot punë për të dënuarit ose këta janë të paaftë për t'u zënë me punë, shpenzimet për nevojat vetjake përballohen nga fondet e administratës së vendit të vuajtjes së dënimit.

6. Punëdhënësit janë të detyruar t'u njohin të dënuarve që janë në marrëdhënie pune me ta, të gjitha të drejtat që gëzojnë punonjës të lirë në bazë të dispozitave në fuqi për sa i përket pagës, kohës së punës dhe pushimit, paaftësisë së përkohshme e të përhershme.

7. Në marrëdhëniet e punës të dënuarit duhet të respektojnë të gjitha detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi dhe kushtet e parashikuara në kontratë. Në rast të kundërt i nënshtrohen sanksioneve ligjore.

8. I dënuari që punon, paguan taksat dhe të gjitha detyrimet e tjera financiare njëjloj si punëtor i lirë.

9. Pjesa e të ardhurave nga puna që u mbetet të dënuarve pas shlyerjes së shpenzimeve për vetëmbajtje, detyrimeve dhe taksave, administrohet nga administrata e vendit të vuajtjes së dënimit, në bazë të rregullores së brendshme të burgut, në favor të të dënuarit.

10. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.19, datë 7.5.1985 dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore që janë në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi